

INTERVISTË ME SKENDER BOSHNIJAKUN

Prishtinë | Data: 4 dhjetor, 2018

Kohëzgjatja: 107 minuta

Të pranishëm:

- Skender Boshnjaku (I intervistuari)
- Aurela Kadriu (Intervistuesja)
- Kaltrina Krasniqi (Intervistuesja/ Kamera)
- Besarta Breznica (Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Aurela Kadriu: Me na prezantu vetën edhe me na tregu diçka për kujtimet e hershme të fëmënisë, domethanë krejt ambientin në të cilën jeni rritë, familjen e ju, çfarë familje ka qenë, çkado që mbani në mend?

Skender Boshnjaku: A mujm me ia fillu?

Aurela Kadriu: Po, po.

Skender Boshnjaku: Shkurt, i lindur jom në vitin 1942. Shkollën fillore e kom kry në Pejë, në shkollën “Haxhi Zeka”. Pastaj kom vazhdu në shkollën prapë fillore se dy klasat i kom kry, kom vazhdu në “Karagaç” ashtu quhej shkolla në Karagaç. Më pastaj jom kthy në shkollën “Ramiz Sadiku” dhe ma n’fund e kom kry gjimnazin atëherë quhej Gjimnazi “Real” në Pejë...

Aurela Kadriu: Zotni Boshnjaku, a ndalemi vetëm pak te familja në shpi...

Skender Boshnjaku: Ah, rreth familjes. Familja, përndryshe babai im Isa ka vdekë, nana ime Hajria ka vdekë, kom ni vëlla Shefqeti. Fëmënia zakonisht më ka kalu në Pejë, kujtimet e hershme janë të lidhuna në një atmosferë të skamjes, të varfërisë. Shkollimin e kom pasë pak si të vështirë në kuptimin e mospasjes së gjanave elementare, mos t’them për libra, për fletore, për lapsa e çkamos tjetër. Mirëpo, në atë varfëri ka ekzistuar ideali dhe prirja, etja për me nxanë, prirja për libra, për dituri e kështu me radhë. Kështu që, gjimnazin e kom kry, thashë në Pejë, Gjimnazi “Real” quhej, sot quhet “Bedri Pejani” dhe që në fëmëjëri m’kujtohen disa njerëz.

Më kujtohet mësuesi i parë Hamdi Tabaku, më kujtohet mësuesi i dytë, se dy klasë fillore kom pasë Hamdi Tabakun. Dy klasë tjera të ndjerin Kamber Pajaziti, më pastaj kom pasë kujdestar të klasës Nexhat Bashën, e kom pasë kujdestar Xhafer Karahodën, e kom pasë kujdestar Muhamet Belegun, e kom pasë kujdestar Shaban Aliun, e kom pasë kujdestar në gjimnaz Riza Çavollin, e kom pasë kujdestar Rexhep Gecin, e kom pasë kujdestar Rexhep Gecin e kështu me radhë.

Edhe jom i lumtun që, sidomos për Ahmet Mehen, Ahmet Kelmendin profesor i gjuhës shqipe t’cilët jo familja... une mendoj që ai mu m’ka ngrit në atë stad ashtu si jam. Prirje për gjuhë, prirje për letërsi,

prirje për lexim dhe të cilit gjithmonë do të jem mirënjohës edhe gjithmonë me rastin e ditës së mësuesit, profesorit une i kujtohem në atë llogarinë time në Facebook. Une me rastin e ditës së mësuesit gjithmonë i kujtoj e kështu me radhë. Dhe unë mendoj që jom ni gjeneratë, ni mohikan i fundit që i boj respekt gjeneratës time, mësuesve t’mi, për të cilët çohem prej vendit edhe me iu admiru, edhe me i respektu derisa te kom grahmën e fundit të jetës.

Përndryshe, Peja më kujtohet, si 18 vjeçar e kom lëshu Pejën. Njerëzit, sidomos m’kujtohen shporeti i Ramës, taksisti Shahin Goska, më kujtohet berberi Rexhep Bogu, më kujtohen shoktë, Faruk... përndryshe kom qenë në gjimnaz në klasë me Faruk Begollin, Enver Hadrin, Bajram Sefën, Ruzhdi Spahiun, thashë Enver Hadrin, Ekrem Kryeziun. Jom krenar që kam qenë shok me ta edhe kem kalu ni lidhje ashtu siç i duhet, qysh i ka hije që sot gjeneratat nuk i kanë përcjellë kët’ solidaritet të përbashët. Jusuf Gacaferrri, shoku, gati me harru, shoku ma i mirë i imi ka qenë Jusuf Gavaferri, t’cilin kem qenë fqj edhe, po ai ka vdekë para meje, po besoj që s’ka me harru derisa të jetoj. Ktu...

Kaltrina Krasniqi: Çfarë qyteti ka qenë Peja?

Skender Boshnjaku: Urdhno?

Kaltrina Krasniqi: Çfarë qyteti ka qenë Peja?

Skender Boshnjaku: Peja ka qenë ni qytet me ni strukturë, me ni imazh të jashtëzakonshëm. Bile, bile ka qenë atraksion për turistat atëherë, kanë fillu me ardhë turistat edhe synimi i parë i turizmit ka qenë Peja, Rugova. Si fëmijë më kujtohen turistët e parë që kanë ardhë të cilët menjëherë janë nxitu me marrë plisin edhe me qitë në kokë edhe si fëmijë afroheshim kështu pa ditë diçka. Por, gjithmonë ka qenë ni kujtim i mirë që atayne iu ka pëlqy edhe Gryka e Rugovës, peisazhi i Pejës, atmosfera e Pejës.

Përndryshe, Peja osht’ qytet të cilin e ndanë Lumbardhi, më kujtohen Ura e Gurit, Ura e Zallit më kujtohet Hotel Korzo, më kujtohen shëtitjet. Atëherë ka qenë traditë, shëtitja në Korzo si njëfarë zbavitje sikurse ka vazhdu ajo shëtitje këtu në Prishtinë ku dilshim edhe takoheshim. Ndoshta edhe dashnitë e para i kem shiqu në lëvizje me shokë, kem kuvendu m’i këmbu disa mendime për detyra dhe kështu me radhë...

Kaltrina Krasniqi: Prej kah ka ardhë ai pasion për arsimim?

Skender Boshnjaku: Pasioni për arsimim, ndoshta tash muj me thanë ka qenë prirja ime, dashuria personale por ka qenë edhe një afeksion, ni afeksion, ni zgjatim, ni rrezatim i mësuesve të cilët edhe pse nuk kanë pasë ndoshta atë pajisje ose përgaditje shkollore për ni mësus... mirëpo, ka ekzistiu ni ideal i tyre t’cilët i ka zvoglu, e ka mangsu, e ka mshef ose e ka, e ka masku atë mospasje të letrave ose diplomës, por kanë pasë ni dashuri për me ofru t’gjitha ato çka ka qenë e mundur në atë kohë.

Përkundër faktit që s’kemi pasë lapsa as fletore, mirëpo kem arritë edhe jem ni gjeneratë që kem arritë. Muj me përmend shumë, qita që i përmenda t’cilët kanë arritë n’jetë edhe përkundër faktit që s’kem pasë, kurgjo s’kem pasë. Prej, prej 10-15 landëve sa kanë qenë në gjimnaz gati shumica kanë

qenë në gjuhën serbo-kroate. Praktikisht gjuha serbo-kroate ka qenë gati si me qenë gjuhë amëtare, bile, bile i kem pasë veç ni orë ma pak gjuhë serbishte. Kështu që, edhe gjuha ka qenë shumë, kanë qenë... shumë kanë kërku edhe më kujtohet që kanë kërku edhe me i mësu përmendsh edhe Betejen e Kosovës, e kështu me radhë mitet serbe të cilët i kemi recitu.

Edhe une kom lexu shumë, ka mungu libri. Une... si sot më kujtohet për shembull, që kemi huazu. Naim Luci i ndjeri, ai ka ikë në Shqipni, ka vdekë, i cili ka pasë libra edhe ka huazu. Për shembull, qysh atëherë m'kujtohen "Sul me lotë" që ka shku dorë për dorë. Mandej, "Këngët e Milosaos" të Jeronim De Radës i kem përshkru me pend, me ngjyrë në banka, në shkalltë e Gjimnazit "Real" ose Gjimnazit "Bedri Pejani". Aty edhe i kem përshkru "Bagëti e Bujqësi" të Naim Frashërit.

Kështu që, me t'vërtetë nuk kem pasë libra, por qato që i kem pasë jom mundu. Përndryshe, kryesisht unë kom pasë prirje me lexu bile edhe mendoj që do t'shkoj në Letërsinë botnore. Kom lexu shumë, bile bile kom lexu në gjimnaz serbisht e kom pasë referat këtë Servantesin "Don Kishotin e Mançës", mandej referat "Luftën dhe paqen", referat Dikensin e kështu me radhë.

Kështu që, jemi ni gjeneratë që kem pasë prirje për lexim edhe ka mbetë sot e kësaj dite. Kështu libri ka mbetë për mu shoku ma i mirë edhe gëzimi ma i mirë edhe takimi ma i mirë. Si nuk e preku ditën niherë librën m'duket se osht' ditë e shkuar edhe... që nuk shfrytëzohet.

Kaltrina Krasniqi: A kanë qenë prindët e juj të arsimum?

Skender Boshnjaku: Jo, jo, jo, jo, të pa arsimum. Nana ka pasë shkollën fillore, baba jo. Kështu që, kjo osht' e vërteta. Plus gjuha brenda është një gjuhë arkaikë e përzime. Kështu që, une gjuhën, gjuhën ma ka ofru profesori i ndjerë Ahmet Meha, edhe ka qenë kënaqësi që në hartimin e tij me marrë notën e mirë. Përpara ka qenë, hartimi ka qenë ajo pasqyra e individit. Une sot e kësaj dite muj me thanë që kur kom qenë në fakultet, në fakultetin e mjeksisë ishte puna me, isha në komision për magjistraturë thashë, a din, testi ma i mirë është me e detyru secilin pse dëshiron këtë magjistraturë me shku, veç me pa testin si shkrun.

E dyta, unë kom dhanë mësim, kthehem pak mbas, në, nja tri vjet në Departamentin e Psikologjisë, kom dhanë abnormalitetin edhe personalitetin. Edhe për mu ka qenë kënaqësi që pos diturisë, eseja, testi, shkrun ese. Për temën që osht' dhanë ma s'pari kom kqyrë si është sintaksa, si është gramatika, si është begatia e gjuhës edhe si osht' rrjedha e mendimit. Kështu që, unë mendoj që secilën prej ktyne njerëzve, testi i parë... unë e kisha bo, "A don me u bo ministër? A çka don me u bo? Veç mjeshtër shkruimi dy fjali edhe ta jepi dorën".

Kështu që, une nuk di sot si qëndron puna e hartimeve veç më duket që duhet me iu përmbajtë hartimeve sikurse që ka qenë më parë. Sot nuk e di si është puna, ndoshta s'po aplikohet edhe s'kem pasë edhe ni gja tjetër, që profesori i gjuhës shqipe gjithmonë kur... me iu tregu që në gjimnazin e Pejës unë kur kom konkuru provim pranus ka pasë, edhe pse kom pasë filloren, shkollën. Domethanë, filloren tetë-vjeçare, suksesin e shkëlqyshëm prapë se prapë jom nënshtru konkursit me u pranë në gjimnaz të Pejës.

Edhe profesori i shqipes që nga dita e parë kur e kem kry klasën e parë në gjimnaz, meniherë na ka dhanë numrin e librave që duhet gjatë pushimeve verore me i lexu. Kështu që, gjithmonë kem pasë një 20 libra deri në 25 me i lexu gjatë pushimeve edhe meniherë me iu referu. Kur ka fillu mësimi meniherë, “Çka ke lexu ti, Skender? Çka?” Edhe plus për çdo libër kush ka thanë duhet me shkru ni dosje, ni përgatitje, ni... t’dhana, çka ke lexu, çka ke kuptu e kështu me radhë.

Kaltrina Krasniqi: Në çfarë... kur po thuni që keni fol gjuhë arkaike n’shpi, çka domethanë ajo?

Skender Boshnjaku: Gjuha e përzime, turqisht e shqipja. Kështu që, ndikimi i turqishtes ka qenë që... ajo ka qenë pengesë e imja shumë e madhe edhe mendoj që ni prej pasojave të sundimit të gjatë otoman osht’ që gjuha shqipe nuk ka qenë aq e zhvillume dhe ka ndiku shumë që kjo anë e jonë, edhe pse ka zgjatë robëria pas sundimit otoman edhe robëria serbe që ka ndiku që ne të ngecemi në rrefimin tonë. Ndoshta edhe te unë po e vreni, por jam mundu që t’jem ma spontan, që rrjedhshëm...

Kështu që, kjo osht’ ajo e mira që Shqipëria megjithëse ka arritë 1912-tën pavarësinë edhe ka arritë barëm njëqind vjet me mendu edhe me jetu në shqip, ajo osht’ bukuria ma e madhe. Dhe mendoj që mos ishte Shqipëria në përkthim, që tash jom t’u iu kthy romaneve që i kom lexu në serbisht, unë mendoj që kishim falimentu. Unë mendoj që ata janë ma t’arrirë, ma të ngritun, ma lexojnë, ma flasin mirë. Unë kom thanë që t’kisha pasë jetën time me lindë edhe niherë, me lindë në Shqipëri se mendoj që ni fëmi pesë-gjashtë vjeçar e din gjuhën ma mirë se une në këtë moshë. Do të thotë, që kem pengesa.

Une sot e kësaj dite ma përpara mendoj në serbisht, mandej e përkthej në shqip. Kështu që, kjo osht’ ni situatë mjaft jo e mirë, edhe sot e kësaj dite përpiqem me lexu sa ma shumë edhe besoni që sot qët’ moment jom t’u lexu “Avanturat e Hakëlberi Finit” [*Adventures of Huckleberry Finn*] të cilin e kom pa edhe filmin, të cilin edhe serbisht e kom lexu po krejt romanët që në serbisht i kom lexu, për s’dyti jom t’u i lexu sot e kësaj dite. Këto tu iu falenderu përkthimeve. Sidomos përkthimeve të jashtëzakonshme të Pjetër Reit i cili e ka përkthi... Servantesin e ka përkthi Fan Noli, po edhe Pjetër Rei. Kështu që, aty, këto që po i flas i kom arritë edhe prej qityne leximeve.

Kaltrina Krasniqi: Mandej në moshën 18 vjeçare keni vendosë me shku ku?

Skender Boshnjaku: Në moshën 18 vjeçare mas kryerjes po ashtu të maturës në Pejë ka qenë ajo tema e maturës, përgatitja. Kom pasë temën “Romani i Kosovës”, qët’, qët’ temë e kom pasë edhe kom shkru për “Besnikun” e Rexhai Surroi, kom shkru për “Karavanin” e Azem Shkrelit, kom shkru për “Rrushi ka nisë me u pjekë” i Sinan Hasanit edhe për cilin roman nuk... këta kanë qenë romanet e parë në gjuhën shqipe në Kosovë.

Edhe mbas kryerjes së maturës unë kom qenë, kom bashkpunu me Radio Prishtinën, herë mbas herë ka qenë “Kolovajsa e të Dieleve” në Radio Prishtinë edhe unë i pyta kolegët e mi, “Ekrem, çka don me studiu? Skender...” ka qenë Skender Shala tjetër, secili këta, këta, këta. Edhe në fund thashë, vetit i drejtova ni pyetje thashë, “Ti Skender çka don me studiu?” Hera e parë ka qenë mjeksia, hera e parë

vetit i kom thanë. Edhe në mënyrë spontane edhe i dërgova reportazhin Radio Prishtinës edhe aty thashë, “Ka q nxënës, ka q shokë të mi kanë me studiu”.

Vendosa edhe në... jom regjistru në Beograd pa provim pranues se e kom pasë suksesin... atëherë kom pasë suksesin e mirë, shkëlqyshëm dhe jom pranu. Edhe ni koleg, Sejdi Berisha, jo ai poeti po Sejdi Berisha osht’ veterinar, ai ka qenë i regjistrum në Fakultetin e Veterinës edhe ai m’lajmëron, “Skender, je pranu në gjimnaz, në, në fakultet edhe du me t’regjistru”. Une s’kom pasë pare me shku me u regjistru, po ai m’ka regjistru mu.

Masandej mas regjistrimit une jom nisë nga treni, nga stacioni i Pejës me ni valixhe të babës, të drunit, fikall vetëm në Beograd me studiu. Pa kurfarë stipendioni, pa kurfarë përkrahje edhe qishtu fikall vetëm kom fillu me studiu në Beograd edhe kështu me radhë.

Kaltrina Krasniqi: Qysh ka qenë me shku prej Pejës në Beograd me 18 vjet?

Skender Boshnjaku: Kjo osht’ ni, besoj që jeta, jeta nuk kom pasë kohë me mendu ashtu, por sikurse me hi me ni lum, në ni oqean, ni det që të merr edhe nuk e din ka shkon. Une qashtu jom fundosë, po mendoj kom hy qët’ lojë t’jetës edhe s’kom mendu shumë. Dhe jom regjistru, në të vërtetë kur kom shku në Beograd ma ka thanë Sejdiu, “Qe Skender indeksi” edhe kom konkuru në... kom banu në konviktin atëherë quhej “Vrdovc”, do baraka para Luftës të Dytë Botnore edhe kom banu n’dhomë me Ekrem, këtë Faruk Begollin, Enver Nimanin, Petrit, Petrit...

Kaltrina Krasniqi: Imami?

Skender Boshnjaku: Jo Imam po, Petrit Begolli, Petrit Begolli, Ali Berisha kem qenë ni dhomë. Ka qenë ni dhomë, barakat shumë të ftofta gjatë dimrit, praktikisht me vrime dhe bora hynte në dhomë aty edhe duhej çdo mëngjes herët... e kem pasë furrën secili me pasë detyrë me shku me ble bukë për mëngjes herët që me u nisë n’fakultet. Edhe aty gati kom qëndru ma i rëndomti po kur vinte radha te dikush tjetër...

Mandej ka qenë puna me e ndez stufën me qymyr, ma tepër pritojshim me ndezë, ma shumë kem qenë në të ftoftë se sa nxehtë. E mandej vitin e dytë kom banu në konviktin e Beogradit t’ri, në Beograd të ri, ni, ni qendër studentore prej 40 mijë studentësh prej pesë blloqeve. Katër blloqe kanë qenë t’meshkujve ndërsa ni bllok i femnave. Mandej kom banu, kom pasë fat në Beograd, në “Ivo Lolla Ribar” ka qenë aty qendra ku kanë ma tepër t’hujtë kanë banu po qashtu m’ra hise.

Mandej kom banu në “Svetozar Peneziq” e n’fund në prapë jom kthy në “Vrdovc” aty u kthy konvikti i ri i studentit, i studentëve edhe aty i kom kry studimet. Studimet i kom regjistru në vitin 1961 kur e kom kry maturën dhe e kom kry në vitin 1966. Unë mendoj që e kom kry në *rok*¹, me notë mesatare t’lartë, “9”. Gjatë studimeve kam qenë, thashë jom nisë pa pare po kom konkuru për kredi në vitin e dytë. Kom bajtë qymyr, gjatë ditëve të verës me shqiptarë në stacionin e trenit në Beograd.

¹ Serbisht: *rok*, afat.

Ndërkohë në vitin e dytë mora kredi, por mas kryrjes së vitit t'dytë student i mirë kom punu si ndihmës asistenti në Institutin e Biokimisë në Beograd, Biokimisë në Beograd. Kështu që, ajo që e kom marr nga, nga paga e punës si ndihmës i asistentit ka qenë shumë ma shumë se kredia. Edhe kredinë që e kom marrë kur e kom kry fakultetin jom kthy në... atëherë ka qenë urdhni ku t'dërgojnë, m'kanë dërgu këtu edhe jom lajmëru në Këshillin Ekzekutiv, atëherë quhej kjo ndërtesë ku është Parlamenti i Kosovës.

Aty një nënpunës, u lajmërova thashë, “Qishtu qishtu... une e kom kry du me shku në Pejë. Une jom nga Peja”. Veç ma ka shkru nifarë akti, veç sa s'më ka thanë, a bon me mshel gojën, “Shko lajmërohu në spital edhe pikë, n'qit spital”. Une... m'kanë shku lot, qysh me ardhë ktu? Qysh me shku? Kom andrru me shku në Pejë, po qishtu jom vendosë.

Kaltrina Krasniqi: Në cilin vit?

Skender Boshnjaku: Në vitin 1966.

Kaltrina Krasniqi: Qysh ka qenë Prishtina në vitin 1966?

Skender Boshnjaku: Prishtina ka qenë ni qytet i vogël me pjesë, e kom përjetu me kubëza, me katror të granitit qendra e Prishtinës. Ka ekzistru hoteli, atëherë quhej Bozhur, masandej Iliria, Parlamenti i Kosovës sot ata e kom përjetu, kom përjetu hapjen e, hapjen, këtë hapjen e kom përjetu kom marrë pjesë na kanë pru prej gjimnazit në hapjen e në vitin '60 të “Trekandshit” [Sheshi Bashkim-Vllaznimi] tash osht' “Adem Jashari”, tash që është renovu.

Me tren kem ardhë, me tren t'shtazëve me vagona na kanë pru ktu edhe e kem qenë kinse t'pranumë në... me përcjellë mitingun e, e, e... ka folë Svetozar Vukmanoviq - Tempo². Përndryshe, më kujtohet rruga, atëherë ka qenë JNA tash UÇK-së n'baltë deri n'gju, stacioni, stacioni aty osht' ni... stacioni i trenit aty n'kand ku osht' ku zbresësh te shkalltë e Arbërisë ose Dragodan ka qenë ni stacion i trenit, stacion tjetër ka qenë aty në largësi aty ku osht' stacioni i trenit i Prishtinës më kujtohen po ashtu rruga, qikjo rrugë. Hotel Grandi osht' hap në vitin 1977, m'kujtohet Bankosi atëherë, m'kujtohet Banka e Ljubljanes sot e asaj dite ktu.

Rrugtë kanë qenë t'ngushta jo të asfaltume, m'kujtohen Mark Isaku rruga po ashtu baltë. Krejt rrugtë kanë qenë me baltë, po Prishtina ka pasë alenë e luleve në Prishtinë, alea e, e...

Kaltrina Krasniqi: Ku ka qenë kjo?

Skender Boshnjaku: Urdhno?

² Svetozar Vukmanoviq - Tempo (1912-2000) ka qenë lider malazezas dhe anëtar i Komitetit Qendror të Lidhjes Komuniste Jugosllave.

Kaltrina Krasniqi: Ku ka qenë kjo?

Skender Boshnjaku: Alea e luleve këtu përballë, përballë ish hotelit tash osht' hoteli i Behxhet Pacollit, aty ka qenë alea e luleve. Mandej, blini e pemtë tjera dekorative që sot e kësaj dite si duket kanë me u zhduk krejt edhe osht' ni fatkeqësi që osht' tash ajo... nuk osht' e imja as e kujtesës teme nuk osht'. Osht' Prishtinë e mbulume me kubza dhe e dedikume për lodra të fëmive, për biçiklista, për... edhe çkamos tjetër. Dhe ajo nuk osht' Prishtinë e imja, se osht' Prishtinë e imja me blini dhe pemtë tjera t'cilat iu kanë përshtatë, shumëvjeçare që me vite janë kultivu, po sot nuk ekzistojnë edhe si duket edhe ma tutje do të zhduken plotësisht.

Kaltrina Krasniqi: Ku u vendosët ju kur erdhët në Prishtinë?

Skender Boshnjaku: Në Prishtinë jom vendosë në rrugën... atëherë s'ka pasë aspak mundësi për shtëpi, për qira. Jom vendosë në rrugën sot quhet "Aca Maroviq" përpara ka qenë ni rrugë, ni lagje ku kanë banu sërëbët dhe...

Kaltrina Krasniqi: Edhe sot quhet ajo "Aca Maroviq"?

Skender Boshnjaku: Jo, ajo quhet tash rruga "Tringë Smajli" në vazhdim prej sheshit Nëna Terezë për skej hotelit të Behxhet Pacollit dhe në drejtim... për skej Hotel Siriusit deri te parku i qytet, aty ka qenë ajo rruga dhe në ni shtëpi t'vjetër kom banu ni vjet gjatë... ma s'pari e kom kry stazhin mandej jom pranë definitivisht në spitalin e përgjithshëm atëherë quhej... kom harru me iu tregu që kur kom ardhë une ka qenë vetëm ndërtesa e sotshme, vetëm ajo ku osht' kirurgjia, vetëm ajo ndërtesë edhe, atëherë quhej, Enti Higjienik. Asnji ndërtesë tjetër nuk ka ekzistë.

Bile e kom ni fotografi, s'mujta me gjetë ku jom fotografu si i ri që shifet vetëm mbas meje në sfondin tem qikjo ndërtesë e Spitalit të Përgjithshëm të Prishtinës. Spitali i Përgjithshëm i Prishtinës osht' kry në vitin 1964-'65 e une kom ardhë në vitin 1966 dhe kom punu deri në vitin 2007 kur kom dalë në pension.

Kaltrina Krasniqi: Tregomni qysh ka ndryshu ai spital prej kur jeni panu ju në punë në vitin 1966?

Skender Boshnjaku: Po unë, Spitali i Prishtinës ka qenë spital për atë kohë ma i madhi në Jugosllavi dhe ka pasë ni, sa i përket obduksioneve, ka pasë përqindje ma t'madh të obduksioneve në atë ish Jugosllavi. Spitali i Pejës, i Prishtinës i ka pasë... e në atë spital kom nderë me iu tregu që i kom taku edhe propë duhet me lujt prej vendit që sot po harrohet të ndjerin edhe oftamologun më të madh të mjekësisë shqiptare Xheladin Dedën, aty kom taku Talat Pallaskën gjithashtu otolaringologu i famshëm i njoftun, aty kom taku Sehadete Mekulin, aty e kom taku... Hajredin Ukellin, aty Simon Dobrecin, aty Gazmend Shaqiri para meje, Hysen Ukmataj internist, po shkoj me reparte thashë, gjinekologjia, Eshref Biqakun radiologji...

Kaltrina Krasniqi: A kanë qenë këta njerëz të gjeneratës t'juj apo... ?

Skender Boshnjaku: Jo, jo para meje, para meje. Me iu tregu të drejtën unë kom qenë ma i riu se kom kry n'kohë. Bile tjetër, ka qenë mjekësia e vështirë edhe gjeneratën t'cilën e kom taku ka ushtru shumë gjatë studimet e mjeksisë se shumica e... Unë kom qenë... para meje ka qenë Musa Haxhiu atë mos ta harroj. Unë mendoj që Musa Haxhiu osht' strumbullari dhe maja e ajkës ose ajka e mjekësisë shqiptare osht' Musa Haxhiu. Edhe gjithmonë kom thanë, "Unë ia kisha fshi këpuctë e Musa Haxhiut".

Ai osht' mjeku që ka ma shumë referenca, shkrime në revista të ndryshme, po ka vdekë në SHBA dhe atje osht' varros. Oh, mos t'harroj që e kom taku edhe Osman Imamin, Dekani i parë i Fakultetit të Mjeksisë, Osman Imami. Kështu që, janë do njerëz që mirë që po i përmendi edhe kurrë s'duhet të harrohen dhe ajo çka osht' kriju prej kthimit të viti 1970 kthimi, mjekësia dhe fatkeqësisht osht' shndërru ni ruinë, ni zhbërje e fakultetit, të cilit mendum që ka me vazhdu traditën e ktyne njerëzve. Plotësisht ka ndryshu e mos t'flas tjera sene.

Kaltrina Krasniqi: A mundeni me na thanë veç... për shkak se na jemi t'ri...

Skender Boshnjaku: Po.

Kaltrina Krasniqi: Unë kom lindë në '81-tën këta kanë lindë në të '90-tat. A mundeni me na kriju ni ide qysh ka qenë qatëherë në '66-'67 kur keni ardhë ju? Edhe mandej gradualisht prej dekadës në dekadë qysh osht' zhvillu, çka osht' ndërto përreth, se po supozoj që ka qenë krejt livadhe veç Ulpiana ka qenë...

Skender Boshnjaku: Po, po, po, po, po. Njerzhtë...

Kaltrina Krasniqi: Ju shkojshit çdo ditë n'punë.

Skender Boshnjaku: Njerzhtë, njerzhtë që, po mendoj për politikë, une sot e kësaj dite nuk muj edhe kur më ofrohet rasti e përmendi Fadil Hoxhën. Osht' ni portal që kta të Gjakovës janë shumë njerëz që aty osht' kultura, aty e kultivojnë kulturën edhe pse mendoj që edhe Peja edhe besoj edhe qytetet tjera nuk po iu thom juve prej kahit... s'jom lokalist, s'jom, s'jom t'gjithë i du. E du edhe Gjakovën, bile me mbiemer Boshnjaku thojnë që, "Je gjakovar" thom, "Po, po" se atje ka Boshnjak edhe se llogarisin si gjakovar edhe thom, "Po", nuk e refuzoj.

Kom shumë shokë të Gjakovës, kom shumë shokë ngamos. Por krahu i lëvizjes i përparimit të Kosovës osht' ramja... me 1 qershor jo, me 1 korrik, me 1 korrik të Aleksandër Rankoviqit dhe ndihmsi i tij që Çeqa Stefanoviq në Plenunim e Brionit. Prej '66-tës murr krah Kosova, i hapi sytë edhe u zhvillu. Ndoshta ditë ma t'mira në zhvillimin e vet që ka pasë gjithë shekullor e nga robëria në ni dritë t'vogël ka qenë ramja dhe përfundimi i karrierës shoveniste të Aleksandër Rankoviqit. I cili ka kriju shumë probleme popullit të Kosovës prej nga blerja ose mledhja e armëve e tjera, e tjera. Plus fshati ka pësua shumë nga *otkup*³ nga... e tjera.

³ Serbisht: *otkup*, taksë mbi prodhimet bujqësore.

Dhe prej atij viti fillon lulzimi i Kosovës, themelohet universiteti, themelohet Fakulteti i Mjeksisë, themelohen edhe fakultetet, degët e tjera, ndërtohen shumë objekte, hapen shumë fabrika të cilat kanë pasë nam, amortizerat, amortizerat, fabrika e motorrave në Gjakovë, fabrika e bicikletave në Pejë, në Gjilan fabrika e radiatorëve, fabrika e municionit në Skenderaj, fabrika e tullave e Podujevës, e tjera, e tjera.

Kështu që, në atë kohë ka përjetu ni zhvillim i cili ashtu qysh më kujtohet edhe ka pasë fakulteti, kanë qenë vetëm në, në, në ka pasë dyqind mijë të punësuar, në mjeksi kanë qenë 15 mijë punëtorë mjeksorë në spitale dhe në institucione të Kosovës. Shumë mjekë u ngritën, morën tenaltzën, kështu që... doktoratura, përpjekjet të cilat, me thanë njerëz shkunë në Amerikë, shkunë... Gazmend Shaqiri ka doktoru në Pragë, tjetër... besa une në Beograd, e gjithë... Une krejt avansimin tem e kom arritë në Beograd me fakultet, me specializim, me magjistraturë edhe me doktoraturë.

Kështu që, krejt kem qenë ashtu pa krahë, pa shpinë ashtu që edhe i ka hije edhe andej edhe kem ushtu ni detyrë që nuk... jom përpjekë që faqebardhë t'i ofrojmë ato çka ka kërku populli edhe kem qenë të ndërgjegjshëm. Kjo ka qenë ajo... edhe zhvillimi i Kosovës ka qenë prej viteve, vitit 1966 dhe praktikisht deri në vitin 1980. Prej '80-tave e këndej fillon Lëvizja Nacional Shoveniste e Kishës së Serbisë, e nacionalistëve të Serbisë, e Akademisë së Shkencave e tjera. Me i zbatu ato të memorandumeve Vaso Çubrilloviqit, të memorandumit të Akademisë së Shkencave në vitin 1986 e kështu me radhë. Deri te ajo çka arriti Kosova që të përmbysët, që të lëvizet edhe të arrihet...

Në vitin 1968 kanë qenë demonstratat e punës une kam qenë ushtar. Kështu që, ato përpjekjet e njerëzve, t'rive, t'rejave erdh kjo që po i thojmë liri, por kjo osht' ni liri shumë e cungume e cila nuk ka arritë me i realizu ato çka osht' dashtë me i realizu se krejt osht' përmbysë. Shëndetësia osht' përmbysë, arsimit osht' përmbysë, shkolla nuk osht' në atë nivel. Unë po thom, nuk kem pasë por kem qenë t'përkushtum deri në fund edhe i kem respektu. Të gjitha këto sot nuk ekzistojnë, as njerëzorja, as dashuria, as respekti i ndërsjellë.

Kështu që, unë po iu referohem menjëherë, zonjusha Aurela si m'u ka afru, meniherë hap e krah e kom pranë. Edhe besoj që ajo që unë mendoj osht' që biografia jeme jeni ju, se biografia e çdo t'moshumi osht' në dorë të rinisë. Edhe jom përpjekë që çdo moment me çdo t'ri t'i afrohem edhe të veshëm si ai, se i riu edhe besoj që gjenerata e juv e keni punën ma të vështirë, por i keni edhe disa përparësi të cilat nuk i kom pasë edhe që mundësojnë meniherë. Teknika, teknologjia ka kriju ato ndryshimet që na kanë mungu në atë kohë e sot ajo iu ofron edhe zvogëlon ato mangësitë tonat edhe ma afër edhe informatat aty osht googli edhe wikipedia edhe meniherë e merrni informatën edhe aty osht' përparësia e juv.

Kështu që, këto ndryshime janë ma shumë teknike-teknologjike, se sa ndryshime të mentalitetit. Sa i përket mentalitetit, na e kemi një avaz të vjetër, vazhdojmë me të jetuarit në mënyrë të natyrshme edhe është nifare forme e kapardisjes, e ni ngazllimi t'rremë, t'jetuarit pa ndjersë pa përpjekje. Kështu që, sot fakulteti i mjeksisë nuk osht' në gjendje të kohës teme, fatkeqësisht. Edhe nuk osht' ka mësohet ashtu qysh osht' dashtë me mësu, se në qat' fakultet, në qat' fakultet e kanë kry gjenerata e

parë osht' Alush Gashi edhe do tjerë t'cilët kanë punu mirë edhe... ka edhe studentë tjerë, ka edhe sot e kësaj dite studentë që i kanë kry, por krejt puntë individuale.

Janë njerëz që kanë shku jashtë, janë do studentë që krenohem me ta osht' student Afrim Lyta janë student e mi, osht' Ferid Agani studentë e mi, une ata i kom pranu në punë. Edhe jom i lumtur që, edhe ata po e përmendi, që jom ai që mas meje kom lanë dikënd që ka mujt me vazhdu edhe plus iu kom thanë atyne, "Në vorrin tim asnjëri s'guxon, jo që s'guxon po s'ka t'drejtë me thanë që ti na i ke pre krahtë" qishtu i kom thanë, "Në vorrin tim..." edhe unë besoj që qysh po zhvillohet puna nuk kanë me përjetu me ardhë në vorrin tim se une do t'vdesë shumë qetë hiç edhe s'kom... pa ceremoni edhe s'ka me leju kërkush me m'ardhë se... edhe i kom thanë.

Mirëpo, osht' diçka që nuk më pëlqen te kjo gjeneratë të cilëve shumë iu kom ofru edhe Afrimit, edhe në Jusuf Ulën, edhe në Ferid Aganin por... janë t'mirë, ma t'mirë se unë edhe janë... besoj që janë tu e aprovu ata çka unë e mendoj, por gjithë këta e kanë braktisë fakultetin, i kanë hap ambulancat private edhe kështu me radhë. Por edhe politika ka ndiku shumë, praktikisht edhe për rojtar të një WC publike duhet me vendosë politika, edhe për ni kand në Fakultet të Mjeksisë duhet me vendosë politika, edhe për çdo gja duhet me vendosë politika.

Kështu që, aty shefi nuk vjen në bazë të aftësive veç n'bazë të përkatjes politike. Unë po iu tregoj që antikomunist... u harrova me përmend Ali Sokolin, shumë... i jashtëzakonshëm, i madh, gjuhën gjermane ka kry jashtë, Xheladin Deda specializimin e ka kry në Romë, e tjera, e tjera. Por, atëherë komunistat nuk e kanë ngucë Xheladin Dedën, bile, bile s'kanë mujt asnji funksionar i lartë me iu afriu pavijonit t'tij. Ata nuk e kanë ngucë.

Merreni me mend, qat' Xheladin Dedën sot e kishin hjekë prej atyhit. Kjo osht' diçka e... në mjeksi duhet ordinimi sikurse në ushtri. Këtu nuk dihet se kush po pin e kush po han. Aty osht' secili gjeneral s'din kond me vet, kond me bo, për ni natë bohet drejtor, shkon ai vjen tjetri me mantil politik. Kështu që, mantili politik osht' ajo e keqja që ka ndodhë dhe që po ndodhë dhe fatkeqësisht që vazhdon të ndodhë.

Pjesa e Dytë

Kaltrina Krasniqi: Zotni Skender, tregonani kur jeni martu?

Skender Boshnjaku: Para se me u martu, ju tregoj që e kreu stazhin dhe fillova meniherë me punu në pavijonin e neuropsikiatrisë. Krejt jeta më ka kalu në neuropsikiatri, 40 vite aty kom punu prej fillimit...

Kaltrina Krasniqi: A osht' diçka që e keni zgjedhë apo...

Skender Boshnjaku: E edhe ata e kom zgjedhë, ata e kom zgjedhë me kompenzu pse nuk shkova në letërsi edhe me kompenzu me psikiatri atë që po shkoj në psikiatri diçka që ia vlen me apliku edhe me zgjanu letërsinë teme në vazhdimësi, me njoftë njeriun dhe njerëzoren edhe që t'jesh psikiatër duhesh

me lexu shumë edhe për atë e kom zgjedhë psikiatrinë. Neuropsikiatrinë, se atëherë quhej neuropsikiatria.

Jom martu në vitin... më... jom martu me... dhe jom regjistru në Komunën e Prishtinës me 26 dhjetor të vitit 1969 dhe simas adeteve e kom marrë grunë. Ajo sot e kësaj dite e ka shtëpinë, “Pubi Miqtë”, ju e dini ku janë “Miqtë”? Ajo është shtëpia e saj. Aty ka lindë. Dhe prej atyhit e kom marrë e kom çu në Pejë, u bo nuse qysh u bo nuse në mënyrë tradicionale. Prej atyhit të nesrit kem hypë në tren edhe kem vazhdu në udhëtim me tren rreth Europës. Kemi shku Beograd, Ljublanë, Milano, Paris jem kthy në Vienë, Pragë, Budapest, Beograd, Fushë Kosovë, Prishtinë.

Kaltrina Krasniqi: Kush osht’ zonja?

Skender Boshnjaku: Zonja osht’ e ka emrin Shukran Osmani, tash e ka mbiemrin Boshnjaku. Për ndryshe osht’ pedagoge e ka kry pedagogjinë në Fakultetin Filozofik të Prishtinës. Ka qenë në fillim laborante mandej e ka kry dhe ka punu si punëtore sociale në shtëpinë e shëndetit atëherë quhej, tash osht’ shtëpia, mjeksia familjare.

Kaltrina Krasniqi: Ku e keni taku zonjën?

Skender Boshnjaku: Urdhno? E kom taku rasisht, ka qenë rekrutimi për ushtri në shtëpinë e shëndetit numër katër t’u shku në Gërm, aty osht’ ni... numër katër, ka qenë stacioni numër katër. Edhe filloi me marrë gjakun e qaq u tut t’u i thanë, “Ma mos u tut se s’o problem”, a din, se une mjek ajo motër, laborante, edhe pak u qetësu. Edhe une, anej knej, edhe aty m’pëlqeu, edhe aty filloi interesimi im.

Shkova në ushtri. Ka fillu korrespondenca gjatë ushtrisë edhe m’ka shërby m’i tejkalu... une pjesën e parë të ushtrisë e kom kry në shkollën, në shkollën e sanitetit në Beograd gjashtë muj dhe mandej pjesa tjetër ka qenë n’kufi me, me Hungarinë, me Austrinë në Slloveni. Megjithëse, ajo ka qenë korrespondenca dhe kur u ktheva nuk e zgjata shumë. Kur jom kthy... kom fillu ushtrinë në 1968 jom kthy më 1969, në mars dhe kem vazhdu lojën deri në dhjetor. Në dhjetor jom martu edhe në mot në dhjetor mbushen plot 50 vjet.

Prej kësaj martesë kanë lindë dy djem, njani m’ka vdekë në vitin 2011, tjetri osht’ Leoni, ky ka qenë Tomori i ndjeri dhe Leoni jeton në Shkup. Osht’ i martum me ni shqiptare juriste, ka ni djalë edhe ni vajzë. Përndryshe, ka jetu në Londër si azilant e kështu.

Kaltrina Krasniqi: Mas martesës ku mandej vazhdut me jetu?

Skender Boshnjaku: Mas martesës unë s’kom vazhdu shumë por jom vendosë te gruja, jom vendosë në qat’ shpi edhe aty kom jetu sot e kësaj dite shkoj aty. Ai lokal, ajo shtëpi osht’ shndërru në lokal, përndryshe nuk ka qenë ideja aty, po ajo osht’ ni storie tjetër që nashta nuk ka t’boj me folë për ata. Nji storie që nuk osht’ e mirë, nuk osht’ e favorshme, nuk osht’ e ndershme ajo çka ka ndodhë me atë shpi.

Kaltrina Krasniqi: Çka ka ndodhë?

Skender Boshnjaku: Oh, çka ka ndodhë, shumë gjana kanë ndodhë. Ndoshta nuk iu intereson kjo punë por mendoj që shumë gjana të turpshme edhe të pakuptshme, kanë ndodhë do gjana të pamundshme edhe të vërteta. Prej përpjekjeve për ta, për qëllime të përfitimit, me rrzu, me ia marrë, me plaçkitë e tjera e tjera, për të cilat janë përballë dhe janë tejkalu edhe osht' shumë signifikative që si ka mujt qajo shtëpi me mbijetu sot e kësaj dite, e rrethume. Urdhno?

Kaltrina Krasniqi: Tregoni si ka qenë se tash ajo...

Skender Boshnjaku: Ajo shtëpi ka qenë njësoj sikurse që ka qenë dhe osht' se kanë rujt në atë shtëpi, po në atë shtëpi ka lindë... se e ka trashëgu nana, gjyshja e ka trashëgu mandej u bartë te vjehrra. Në atë shtëpi ka lindë vjehrra, i ka dy, dy letër identifikime ose letërnjoftime njëra në vitin 1908 tjetra 1912. Por, sido që te merrsh, në qat' shtëpi ka lindë nana e grusë në vitin 1912, praktikisht ajo osht' shtëpi e shekullit të XIX.

Dhe me vullnetin tim të çeliktë të pamundurën e kom bo t'mundshme që të krijohet ni oazë. Ate ua kom kushtu juve. Unë besoj që aty frymohet në shqip, mendohet në shqip dhe besoj që aty ka pasë kurfarë... edhe me pytë Dardanin, Dardan Ibrahimin se çfarë kanë qenë qëndrimet e mia ndaj tij, ai mundet me iu tregu. Sinqerisht mundet me iu tregu se çfarë kom pasë prirje për me mbetë.

Aty ka qenë ma s'pari "Irish Pub-i" masandej e merr Dardan Ibrahimin me vllaun Albanin dhe me ni koleg tjetër. Dhe kom përjetu që e kanë rrzu, po, po, e kanë rrzu, kanë fillu i kom nxanë t'u i hjekë trarët e çatisë i kom nxanë. I kom nxanë që kanë tentu me ia hek emrat e grusë edhe motrës t'grusë që nana iu ka bartë pronësinë në çikën e vet, në Shukranën dhe në Gjylnazën. Ajo dy çika i ka pasë. Përndryshe, ka qenë gru bujare e cila ka përjetu ni... burri i saj Zeneli edhe ai qashtu të njejtin fat u vendosë në këtë shtëpi, ka qenë gjellbërës dhe...

Ai përndryshe me prejardhje nga Prizreni dhe gjellbamës ka pasë... ka ikë në vitin 1945 në Shqipni dhe gruaja ime ka qenë në bark t'nanës t'vet. Edhe Zeneli, i ndjerë, ai ka vdekë në Shqipni edhe ai thotë, "Gru po nisëm", "Jo burri jem une s'muna me u nisë, nuk muj me lanë nanën tem" se edhe nana e saj me to, gjyshja e grusë. Dhe kshtu ajo jeton prej vitit 1945 derisa vdes vjehrra pa burrë me dy çika t'cilat... po ashtu edhe gruaja ime edhe nana kanë pasë përjetime të randa shumë prej komunistëve pse burri i ka ikë edhe tash i kanë bastisë.

Shumë bastisje ka pasë, bile gruaja... unë tash s'po thom që kom qenë i detyrum as s'po thom që p'e pshtyj ose tash jom kështu, por gjithmonë kom pranu dhe e pranoj, kom qenë anëtarë i Lidhjes së Komunistëve të Kosovës edhe jom krenar që kom qenë anëtarë i lëvizjes, i... ku ka qenë edhe Fadil Hoxha kryetar edhe njerz të që... edhe jom i lumtur edhe kom thanë se Fadil Hoxha emri i tij ka me qenë, ka me qenë i gdhendun në historinë moderne të Kosovës, kaq.

Dhe kjo osht' qajo që edhe unë... m'thoshte gruaja, "T'lo, duhesh me dalë prej Lidhjes të Komunistëve" edhe... po, po se shumë përjetime t'randa ka pasë edhe plus policia, milicia edhe uniforma sot e kësaj

dite osht' kujtesë e randë për grunë teme. Edhe nonstop, sot e kësaj dite ka frikë prej uniformës se i kanë hi si çikë e re, vajzë e re i kanë hi... edhe sot e kësaj dite e kanë rujt letrën e bastisjes. Plus iu kanë marrë krejt me çylyma, me t'gjitha ato ushqime që kanë pasë, i kanë marrë krejt. Edhe kanë jetu, qysh kanë jetu ato e dijnë. Është ni familje, mikro familje.

Kështu që, unë jom vendosë aty, mu m'ka përjetu vjehrra edhe si djalë edhe si dhandërr. Edhe kom qenë i përpiktë... une besoj që gruja, femna shqiptare kanë dhanë shumë ma shumë sesa që burri shqiptar i ka dhanë grave. Edhe muj me përmend që nacional shovenizmi sërb ma s'pari e ka ataku femnën shqiptare, me ni përbuzje... se femna shqiptare osht' makinë e larjes. Kjo osht' ni përbuzje ma e randë....

Edhe po çuditem qysh sot e kësaj dite ekziston ni arbitraritet. Shqiptari osht' qenie arbitrar apo autoritare dhe pak ka qasje në... ajo çka ka dhanë gruja, femnat shqiptare për... gruja ka kositë me bebën e vet në krah, e burri ka qenë n'punë tjera, gruja... burri u kthy, e ky e ka shtri komen me ia la komtë e tjera, e tjera. Edhe kjo dhunë sot e kësaj dite osht'... ekziston edhe... plus edhe policia nuk ka qasje t'mirë ndaj, ndaj dhunës.

Dhe e kom pa ni grafit, shumë kom qef me i përcjell grafitet edhe e kom ni koleksion t'madh. Edhe kom shkru, jom marrë me art edhe s'po vazhdoj tjetër.

Kaltrina Krasniqi: Tregomni qysh ka qenë, qysh ka qenë e pozicionume shpija qatëherë në të '60-tat në raport me tash. Po mendoj, qysh ka qenë qajo lagje se tash është krejtësisht tjetër.

Skender Boshnjaku: Ajo lagje... qajo shpi, qysh ka qenë qashtu qysh osht' edhe shpijat tjera familjare, e gjitha, të gjithë janë shpërngulë. Kur kom ardhë une në atë ndërtesë, përballë që osht' ajo ka qenë ndërtesa e ndërtume, bile ia kanë marrë ni pjesë t'kësaj shpije se kjo shtëpi e ka pasë ndërtimin kah, atëherë quhej "Ramiz Sadiku" dhe oborrin e ka pasë deri n'skaj dhe ajo rrugë ka qenë me kocka, me kubza të granitit. Dhe ajo shtëpi u ndërtu në vitet e '50-ta dhe aty janë vendosë t'gjithë njerëzit që e kanë udhëheq Radio Prishtinën, Rexhai Surroi, Akil Koci, Nebi Dino...

Kaltrina Krasniqi: Veç të qartësohemi...

Skender Boshnjaku: Urdhno?

Kaltrina Krasniqi: Jemi t'u folë për... vetëm të qartësohemi, jemi t'u folë për ndërtesën ku osht' tash kjo, Shoqata e Pensionerëve apo...

Skender Boshnjaku: E ku osht' shoqata aty ka qenë ni shtëpi... kanë qenë shtëpija t'vjetra, ka qenë furra e Sylës ka kqyrë kah rruga e, tash "Agim Ramadani", ma poshtë në vazhdim të kësaj te taksistat këndeja ka qenë djathtas ni shitore e pemve, perimeve, n'kat ka banu ni serbe. Në vazhdimësi, prapë ni shtëpi vogël ka banu, sot e kësaj dite ky, ni laborant s'më kujtohet. Po ashtu, ka qenë ni shtëpi e vjetër e bukur, ka qenë dedikume për Lidhjen e Shkrimtarëve të Kosovës, shumë shtëpi e bukur e mirë, por u rrzu dhe këtë pjesë deri te... po ashtu ka qenë ni shtëpi në vazhdim... këpucëtari ky Macula, ni

këpucëtar Macula përfundi bukëpjekësit, Sylës, ka qenë këpucëtari Sylë, ky Macula baba i këtyne Maculëve çka janë...

Kaltrina Krasniqi: Kompozitor?

Skender Boshnjaku: Kompozitor edhe bendi i njoftun dikur, sot e kësaj dite vëllau i... ose mixha i Njazi Maculës, mjek kolegu im, Njazi Macula neuropsikiatër. Dhe përfundi ka qenë po ashtu ni shtëpi e vjetër, ka banu aty Kelmendi, Kelmendi tash djali i tij Agimi m'doket, Agim Kelmendi. Ai s'di... edhe ai osht' marrë me letërsi, me folklor e me çkamos. E krejt ai rend n'fund ni kandi të 90 shkallë.... Ajo pjesë rrxohet dhe ndërtohet. Fillon ndërtimi, kryhet shpronësimi dhe fillon ndërtimi i Shtëpisë së Pensionistëve në vitin 1973 dhe kryhet deri në vitin '75- '76. Kryhet ndërtimi dhe aty vendosen banorët dhe Shoqata e Pensionistëve, qashtu osht'.

Kaltrina Krasniqi: Mirëpo, mandej aty vazhdon, vazhdojnë krejt ndërtesat përreth me u ndërtu apo?

Skender Boshnjaku: E kështu në vazhdim ajo ndërtesë e Radio Prishtinës ka qenë kur kom ardhë unë dhe për skaj kësaj shtëpie t'grusë, sot e kësaj dite osht' ni shtëpi ku ka qenë shtëpia e, shtëpiza e punëtorëve të "Ramiz Sadikut" të cilët e kanë ndërtu atë shtëpi kolektive, e dedikume për Radio Prishtinën. Në vazhdimësi, po ashtu ka qenë ni shtëpi e vjetër, ajo osht' rru dhe n'fund, n'sfond të kësaj pjese, midis kësaj ndërtese kolektive dhe hotelit, atëherë quhej "Iliria" osht' qujt ma s'pari "Bozhuri" mandej "Iliria" mandej tash e murr Pacolli dhe në fund të, të... osht' teatri.

E tash kto ndërtime... unë e kom edhe letrën e shkrueme t'cilët nuk po m'pranojnë... janë ilegale, ilegjitime. Prej kësaj ndërtese që osht' përballë deri te ndërtesa e Behxhet Pacollit. Ajo ndërtesë, ai hotel osht' ilegjitim, ilegal, jofunksional dhe shumëçka tjetër.

Aurela Kadriu: Qysh ka qenë "Bozhuri" kur ka qenë aty?

Skender Boshnjaku: Po ka qenë, po ka qenë ni hotel i mrekullushëm. Aty krejt gjeneratat janë taku, aty unë e kom përjetu edhe me prit Vitin e Ri, po, po. Këtë pjesën osht' qujtë "Arabeska", këtë pjesë në hymje. Aty ka qenë në podrum Shoqata e Artistëve Figurativ, aty ka qenë ni teracë e mrekullueshme që verës aty ka lujt Ukë Brizani me trupë, aty kanë qenë njerzhtë tjerë shumë, aty vera nuk ka mujt pa kalu pa hi aty me pi kafe, ka pasë shumë ndërtesë t'mirë.

Edhe si interesant krejt osht' kjo e kamuflume edhe unë i kom tregu, kom kërkun prej... kur ke ekspozita, se unë jom merak edhe për art. Mendoj që në fund jeta ime me i taku komunitetit artistik të artit. Ke në Galerinë e Arteve, kujtesa kolektive e arqitekturës, aty u përmend Bashkim Fehmiu, Qemajl Nallbani dhe arkitektë tjerë të cilët kanë kontribu në arqitekturën e Kosovës me arkitektë t'njoftun.

Mirëpo, aty çashtja e "Ilirisë" është e mbyllun. Tash mos më shtini me fol ma tutje, po, muj me fol, muj me fol. Kjo osht' diçka që... s'osht' dashtë as me u rru, plus këtë hotel e ka ble ma s'pari njoni, s'po ia përmendi emnin, ia ka shitë Bexhetit. Bexheti mrena natës e ka rrxu. Praktikisht e ka rrxu dhe e ka ngritë këtë hotel që s'osht' hotel. Unë mendoj që osht' ni çorr-sokak i Çernobilit, ma shumë ka ciment

aty e beton, hekër se sa... Çernobili, ku në vitin 1986 në Ukrainë shpërtheu ajo... jo spitali, por centrali bërthamor. Ajo s'ka kurfarë estetike. Ajo osht' e turpshme kado që ta kqyrësh, osht'...

Plus ka dalë jashta *gabaritit*.⁴ Une e kom praktikisht çdo pllam toke... se aty kom jetu edhe sot e kësaj dite shkoj aty me pi ni kafe, e kom skicën që ka bo Instituti Gjeodezik i Beogradit, gabariti, ka bo llogaritjen edhe të hotelit edhe të gjitha shtëpiave përreth si kanë qenë. Plus, ky e ka tejkalu çdo normë të kufinit, mirëpo krejt parja edhe krejt senet i kanë kry n'këtë punë.

Aurela Kadriu: E “Unionin”?

Skender Boshnjaku: Urdhno?

Aurela Kadriu: E “Unionin” se ju edhe “Unionin” e keni pasë afër?

Skender Boshnjaku: “Unioni” afër po edhe “Unioni” kom marrë pjesë në shumë protesta që të shndërrohet në Galeri të Arteve Moderne por... edhe “Unioni” praktikisht veç osht' skelet, e kanë ndryshu pamjen totalisht...

Aurela Kadriu: Qysh ka qenë?

Skender Boshnjaku: Ka qenë, objekti osht' austriak, ni objekt austriak dhe dihet data e 1926 që osht' ndërtu afër ka qenë... e kom fotografinë e Xhamia e Llokaçit. Xhamia e Llokaçit osht' rrxu për me u ndërtu hoteli “Iliria”, “Bozhuri” dhe krejt osht' çashtje politike kjo, kjo osht' çashtje politike, mafioze plus ajo që shifet ajo qeshmja përballë “Simonit”... më kujtohet edhe Simon Shiroka, Simon Shiroka... plus aty ka qenë vend ku jem ulë kem pi kafe, kem këmby... unë e kom ni punim, kom koleksion të punimeve, kom ni, ni grafikë të Simon Shirokës dhe aty ka qenë qeshmja, kroni i Xhamisë së Llokaçit.

Xhamia e Llokaçit ka qenë afër, afër qaty... e kom fotografinë, s'e kom pru po e kom fotografinë. E du vjetërsinë shumë dhe... plus tregon vjehrra që ka pasë përpjekje shumë derisa... se ka dalë shumë ujë aty derisa janë ngritë, janë vendos themelet e hotelit. Shumë ka pasë përpjekje se ka dalë uji, ka dalë uji atëherë, pse osht' rrxu xhamia, pse kjo... kështu që aty janë ato gojëdhana të vështirësive pse u rrxu xhamia.

Kështu që, kjo osht' diçka që sot as që... ma mirë kish me qenë edhe kjo puna e e Gërmisë, e Gërmija... kjo shtëpia e mallnave mas meje osht' ndërtu, ma vonë osht' ndërtu, viteve '71-'72, po mendoj viteve '70-ta o ndërtu Gërmia. Ka qenë shtëpia e parë e mallnave, ka qenë përballë ku... përballë përmendorës së Zahir Pajazitit, aty ka qenë shtëpia e mallnave Gërmia, e kjo tjetra osht' kjo këtu.

Kaltrina Krasniqi: Çka ka pasë aty?

⁴ *Gabarit*, term francez që përdoret për të përshkruar planin në bazë të së cilës është planifikuar aspekti arkitekturor, në këtë rasti plani i lagjes.

Skender Boshnjaku: Aty ka pasë, ka pasë liftin...

Kaltrina Krasniqi: Jo, jo çka ka pasë para Gërmisë, para se me...

Skender Boshnjaku: Kanë qenë shtëpia të vjetra, shtëpia të vjetra janë rruzu edhe janë ndërtu... në vazhdimësi... kështu me iu tregu që si t'del prej Simon Shirokës shkon kah qendra, kah ministria kjo ndërtesa e qeverisë që osht' meniherë ka qenë ni librari, djathtas t'u shku kah Këshilli Ekzekutiv kanë qenë rrobaqepsa, ni rrobaqeps, dy rrobaqepsa, ka qenë nji... knej libraria mandej në vazhdim ka qenë restoranti i peshkut, mandej ka qenë restoranti i peshkut, ka qenë ni barnatore për... bujqësore, mandej ka qenë ni universal, universal shitore për konsum të përgjithshëm universal, majtas ka qenë... prej fillimit ka qenë Jugoplastika shitore e veshmbathjeve, këpucëve, aty ka qenë fillimisht n'qat'... ka qenë shumë e vogël qebaptorja e... jo qebaptorja po gjelltorja e babës t'grusë. Në vazhdim ka qenë ni shtëpi e vjetër ku thuhet se ka qenë konsulat i Serbisë, ka pasë nifarë *pozlom* [Serb. prarim] ke hy në, në korzo apo, qysh u qujtë...

Aurela Kadriu: Ambëltorja a?

Skender Boshnjaku: Jo ambëltore, po qebatore. Ka qenë djathtas qebaptorja majtas prapë do shitore dhe ka qenë ni lokal veror "Kozara", "Kozara", aty "Kozara" dhe në vazhdim osht' orëndreqësi Faruk Panduklu, qiky që osht' sot e kësaj dite. Mandej prapë në fund të rrugës ka qenë orëndreqësi Daci, Daci sot djali i tij e ka në Pallatin e Rinisë...

Kaltrina Krasniqi: Dyqanin?

Skender Boshnjaku: Po, dyqanin që merret me orë edhe me punë t'shitjes t'orëve edhe tjera që janë t'lidhura me sy, syza e krejt. Mandej kthehesh majtas edhe vazhdon... ka qenë ni rrojtoje ku ka punu baba i Mendës, baba i Mendës...

Kaltrina Krasniqi: Ku ka qenë kjo?

Skender Boshnjaku: Meniherë në vazhdim, në vazhdim... Posta e vjetër ka qenë e përballë postës t'vjetër ka qenë ni shtëpi e vjetër aty ka qenë Menda, baba i tij, mandej vazhdoi vëllau, vëllau që... i tij tash osht' në Amerikë. E Menda, aty s'ka punu Menda po vllau i tij Meti, Meti. Aty shumë herë jom qethë, aty edhe fëmitë e mi janë qethë. Në vazhdim ka qenë, prapë në atë rrugicën që sot e kësaj dite ekziston, djathtas kanë qenë do shtëpi të vjetra mandej ka qenë qebaptorja "Sarajeva", majtas ka qenë ni shitore e mishit mandej u shndërru në barnatore te ky Amir Agani.

Në vazhdim prapë janë do struktura që kanë qenë sot e kësaj dite, aty osht' ni berber, ni i ndreq këpucët e kështu me radhë. Në fund ka qenë po ashtu ni shitore ku janë shitë pllaka të gramofonit, shumë e vogël, ngushtë, pllaka të gramofonit. Aty kom ble operën e Mascagni, Giuseppe Verdit e kështu me radhë. E në vazhdim majtas, si të kthehesh majtas ka qenë ni ndërtesë aty ka banu... aty osht' rrxu ndërtu kjo... n'kand aty ku osht' ndërtesë për shitjen e teshave. E në fillim që shkon para

Raiffaisen Bankës, aty ka qenë ni ndërtesë e vitit 1922 e vjetër, aty ka punu ni mjek Kozarac, përballë Kino Rinia, përballë.

Shumë herë kom shku në kinema aty mandej u hap edhe kinoja përballë në katin e dytë, plus në vazhdim ka qenë, ka punu në vazhdim Simon Shiroka, kanë qenë do banesa kështu ni katëshe, të vogla. Ndërtimi ka qenë i parë në Taslixhe. Ndërtimtari t'cilën nuk ka guxë kërkush me deviju, po ka qenë qashtu të vogla, të mira me standarde të atëhershme. Më pastaj fillon... e kom përjetu... kjo pjesë... aty janë bo shumë ndryshime t'mdha, kom përjetu që të... kur kom ardhë në Prishtinë në vitin '66-'67 m'i pa Moto Krosin në... këtu Dragodan, atëherë quhej Dragodan, vrapimet Moto Kros.

Praktikisht ajo pjesë prej fillimit deri në fund ka qenë vneshta, vneshta. Kurgjo s'ka pasë në vitet e '60-ta. Masandej fillon rendi i parë, aty fillon do mjekë e do tjerë me ndërtu rendin e parë. Mandej fillon rendi i dytë e kështu me radhë. Kështu që, ato kanë qenë ndërtesa që sot e kësaj dite e kanë rujtë atë bukurinë e vet, intimitetin, gjelbrimin. E këto që po ndërtohen sot janë iracionale, jo racionale dikush po i thotë *bruality* [brutale] por i përgjigjet se çfarë jemi na me të vërtetë ni arqitekturë brutale.

Po edhe kom shkru, ka shkru Eliza Hoxha ka shkru, librin e kom, jo s'e kom po i kom artikujt t'saj, kanë shkru shumë njerëz po besoj që kërkush s'ka... s'u përpjekë me t'vërtetë me ndalë kta. Unë jom i... krenar që e kom rujt qata që osht', jom krenar që osht' rujt ni qendër që sot e kësaj dite edhe... edhe diqysh kalohet përsaj asaj shpije sikurse maca rreth mishit ose hoxha rreth minarës. Nuk e di pse, por për çashtje politike edhe të përfitimit e kështu me radhë.

Përndryshe, aty, a muj me thanë edhe këtë? Përndryshe, sipas informatave të sigurta ka mendu Behxhet Pacolli me ndërtu hotelin 20 katësh edhe krejt ajo pjesë me u marrë me u gllabëru, por s'ka arritë, sepse ka arritë në pengesën teme. Unë kom thanë, kom kërkua disa here bisedë me të që... po kom shku edhe me grunë edhe me krejt. Se krejt ato ndërtime aty janë bo ndërtime ilegale që ai i ka financu edhe janë bo përpjekje që me u bartë prej atyhit edhe kto ndërtime ilegale që janë bo kanë hy nëpër oborr, krejt ato kanalizime nëpër oborr, jom anku po kërkush s'ka thirrë. Unë e kom ni bagazh, ni, ni strajcë, dy strajca që me e ngarku ni gomar prej letrave e gjithë tjerave.

Pjesa e Tretë

Kaltrina Krasniqi: Zotni Boshnjaku, ju i keni përfundu studimet në Beograd edhe po supozoj që mandej keni vazhdu me studime tjera, me magjistraturë edhe doktoraturë...

Skender Boshnjaku: Po.

Kaltrina Krasniqi: edhe orientimin, keni vendosë me qenë në neuropsikiatri...

Skender Boshnjaku: Po.

Kaltrina Krasniqi: A mundeni me na fol pak ma detajisht pse ka qenë ky vendim, pse iu ka interesu kaq shumë mendja njerëzore?

Skender Boshnjaku: Paj unë jom... gjithmonë për mu ka qenë jeta ni pikëpytje edhe gjithmonë kom pasë prirje me i sfidu...

Kaltrina Krasniqi: N'rregull është veç printeri.

Skender Boshnjaku: Me i sfidu diçka që osht' e randë. Gjithmonë... kurrë nuk jom friku nga vështirësitë dhe e kom marrë mjeksinë s'jom friku. E kom marrë neuropsikiatrinë për me vërtetu vetën a jom ai që e du edhe me vullnet dhe me dashuri. Vullneti dhe dashuria për punën m'kanë majt rrafsh 40 vjet. Gjatë asaj kohe, të kom tregu i kom kry, thashë, magistraturën e kom pasë temën... gjithë i kom pasë mentorët e Beogradit, profesorët e mi në Beograd. Edhe ka qenë e planifikume që atje me punu si asistent, por s'kom pranu edhe u hap konkursi edhe erdh profesori, Rakiçi, Kryetari i Shkencave të Serbisë, atje isha ushtar dhe lajmëroi tha, "Duhesh me konkuru" po s'kom konkuru, s'kom pranu.

Dhe kom fillu ma s'pari si mjek i përgjithshëm, mandej mjek, më ofrun specializimin dy vjet kom kalu në Prishtinë ni vjet në Beograd. Gjatë kohës së Beogradit e kom kry magistraturën edhe e kom kry elektro-fiziologjinë. Jom kthy, kom punu ditë e natë pa kurfarë angazhimi, pa kurfarë pengese. Kom pasë kah 100-200 pacientë në ditë se s'ka pasë neuropsikiatër. Plus neuropsikiatrat e parë kanë qenë serbë dhe ka mungu ajo... edhe kom pasë ideal që të mos shkoj... të mos ndërtohet një objekt.

Çdo shoqëri ka nifarë averzioni ndaj psikiatrisë edhe shoqnia jonë sot e kësaj dite ka paragjykime edhe për psikiatri edhe për probleme mendore që s'osht' dashtë. Mirëpo, ka edhe edhe shoqëri tjera moderne, ma moderne se shoqëria jonë që kanë paragjykime. Mirëpo, jom përpjekë që medoemos të ngritet qajo ndërtesë ku o sot. Ne ma s'pari... gjithmonë kem pasë... në neuropsikiatri ka pasë ni shtytje, gjithmonë kem pasë... pavijoni ka qenë në katin e parë përdhesë edhe i gjanë dikund... shembull ka ndodhë në vitin 1996, epidemia e tifos, edhe menihërë mushe neuropsikiatrinë me tifo, erdh epidemia e verdhëz mushe pavijonin me pacientë të verdhëz e tjera.

Kështu që, une kom përjetu edhe në vitin 1972, ju s'e dini, me epideminë e variolës, e lisë që prej ni haxhiu që ka qenë në Mekë... në Beograd osht' shfaq edhe ka qenë filmi që ka pasë do simptome s'kanë ditë ku osht', e u vendosë... ka pasë diçka në lëkurë po edhe ata të lëkurës janë smu se s'kanë ditë për çka osht' fjala. Kështu që, qishtu ka qenë viti 1972, bile e kom ni pikturë që ia ka kushtu Nebih Muriqi variolës, e kom unë ata e kom marrë.

Dhe prej vitit 1966 deri në vitin '75 kem qenë në atë pavijon, prej vitit 1975 deri në vitin 1985 kem qenë me nifarë barake. Ajo osht' rrxu ni barakë, prej vitit 1985 u hap klinika e neuropsikitarisë ajo që osht' këtu sot e kësaj dite. Jom krenar që jom themelues, i kom të gjitha dokumentet bile unë edhe idenë e projektimit e kom n'shpi. Sot mundet gjithkush me thanë... sot janë përpjekjet m'u harru kjo, por nuk osht' për harresë.

Kaltrina Krasniqi: Tregomni çka... si e ka afektu departamentin vitet e '90-ta punën profesionale?

Skender Boshnjaku: S'pari ka qenë ideal me qenë... me iu shërby njerëzve, me iu shërby... e kom ndi vetën shumë krenar që jom në kohë i ri me iu shërby njerëzve. S'ka shpi që s'kom shku, s'ka fshat që s'kom shku me kerrin tem. Në Prishtinë s'ka vend që s'kom hy edhe që s'kom kry... kom qenë krenar që po m'thrret. Plus edhe krejt garniturën e atëhershme kanë pasë besim n'mu si serbë, shqiptarë kanë pasë besim në mu. Dhe kom ushqy atë ideal edhe deri në fund të jetës jom përpjekë që t'dal s'paku me gjysë, me gjysmën e ftyrës t'zbardhun, se osht' e pamundun pa gabu. Veç prapë se prapë kom arritë që mos t'jem pjesë e aferave e shumë seneve tjera që kolegët e mi ma t'ri devijun edhe u bonën pjesë e aferave të ndryshme që është diçka e papëlqyshme.

Dhe kom punu. Krahas punës, kom punu edhe kom shkru. Jom marr me ekspozita, kom shkru tre libra rreth ekspozitave që i kom përcjellë në Kosovë edhe jashtë Kosovës. Mandej kom vazhdu me interesimin për grafitet, kom koleksionin e madh të grafitëve edhe kom botu librin "Grafitet e Prishtinës" ia kom kushtu juve, t'rive grafitin... edhe ka shku pa punë, pa rre tupani se s'e kom bo ata për kumeditë çka, por ja u kom kushtu... edhe libri i parë i grafitëve është botu muj me iu dërgu.

Kështu që... mandej kom vazhdu me... puna ime, në vend që m'u anku, s'kom zakon me u anku, jo kështu po bon, kështu s'po bon, e s'duhet kështu. Kom thanë, "Skender, lej hiq fjalëve. Veç bon çka osht' mirë me u bo edhe me shërby si shembull". Unë jom shumë i zhgënjym me ndotjen, me bërlllog të Prishtinës e të Kosovës. Kom thanë, hajde ti bonu diçka që le t'sheh... edhe s'e kom turp une me shti kokën në kazan të plehrave... bile vajzat edhe zonjushat edhe tjetër e mbyllin hundën kur t'më shohin mu rreth kazanit të plehrave... t'u marrë njerëzit material edhe prej tyne kom arritë me rikonfigur, me i bo krejt kompozicionet tjera që s'kanë të bojnë me bërlllog.

Edhe kom thanë, si osht' e mundun që prej bërlllogu me u bo diçka që... ma afër e kom bërlllogun fizik se sa bërlllogun human edhe u kom thanë me ni ekspozitë që m'u ka hapë s'voni që, "Në Kosovë po rritet, po shtohet edhe bërlllogu fizik edhe human. Por, jom përpjekë që bërlllogun fizik me formu kompozicion tjetër që ai bërlllogu human le të merr shembull që edhe ai t'mos harron që s'duhet me u gjujt".

Kaltrina Krasniqi: Zotni Boshnjaku, ku keni qenë gjatë viteve të '90-ta?

Skender Boshnjaku: Gjatë viteve të '90-ta kom qenë në Prishtinë, ëëë tanë kohën... deri... tanë kohën kom qenë në Prishtinë.

Kaltrina Krasniqi: A keni vazhdu profesionin apo qysh ka qenë për juve?

Skender Boshnjaku: Nonstop... e kështu, mbas masave të dhunshme të Millosheviqit, gjithë tjerat kanë hy masat mas voni kanë hy te na në klinikën tonë t'fundit. Po ju tregoj të drejtën unë kom qenë i mendimit që duhet me dhanë rezistencë deri në fund dhe kanë qenë naiv shumë mjekë, shumë njerëz që... sikurse që osht' naiv ky... tash nëse... mos ta përmendi... ndoshta që thotë, "Me rastin e ngritjes të... mundet me na njoftë Serbia". Qashtu kem bo edhe kanë bo shqiptartë, e kem bo viteve kur kanë

fillu ato protestat kundër dhunës, kundër dhunës edhe Serbisë e tjera, që nëse une me dal meniherë mbrenda dy mujve kthehem në punë.

Unë kom taku mjektë që kanë qajt, “Kuku, çka bona që dola”. Nga përvoja, jem mbledhë. Plus po ju tregoj të drejtën i kom pytë edhe njerëzit, s’po thom kënd mos të keqpërdori emrin e tyne, i kom pytë m’kanë thanë... edhe vet kom qenë, jemi mledhë, “Ma mirë t’rrijmë këtu, se na shqiptartë popullin tonë p’e ushqejmë, p’e kqyrim”. E unë besoj që viteve të ‘90-ta, i kom thanë vetit edhe pse kom arritë... m’kanë pshty edhe fëmija mi. Qeky Leoni m’ka pshty m’ka thanë, “Ti je i poshtërt, ti je kështu, ti po rrin me shkiqe, ti kështu”, kom thanë, “Jo, ti kqyre punën tane” edhe kom arritë që në korzo kur dilshim, “Kqyre ky shpiuni, kqyre ky shkau” e kështu me radhë.

Ishalla këto nuk shënohen, po edhe... mirëpo kem mbetë. Puna ma humane kom thanë masi kem mbetë, puno me nderë. E puna ime ma e ndershme ka qenë në qat’ kohë të viteve ‘90-ta plot prej viteve ‘89 deri ‘90-ta. Kem punu ditë e natë, jom përpjekë gjitha senet... edhe kem qenë qaq solidar që nuk ju merr mendja. Bile drejtori i dhunshëm thoshte, “Dikush po ju mëson juve,” thashë, “Jo. Na jemi të urtë, na dojmë me kqyrë punën tonë edhe pikë”.

Por, aty ka pasë njerëz që, “Jo ti je kështu, ti je kështu...” duhet me dhanë rezistencë plus, tjetër mjekë kanë dalë por kanë ushtru punën private, kanë lulzu privatisht, kanë qenë ma të tmerrshëm sesa serbtë. Bile thoshte kolegu serb, “Kqyre, shoktë e tu po marrin *prepodne* [paradite] ma shumë sesa ne që po marrim. Ne po na japin ata çka po na ofrojnë”. Edhe bile jom përpjekë ma mirë me i kqyrë sikurse sot qysh i kqyrin shqiptartë në Beograd. Kështu që... edhe ka dalë mirë, edhe kem bo ni punë humane edhe ma t’mirë sesa ata që kanë dalë, kolegu jem ka dalë e ka hapë ambulancën private, ka lulzu.

Edhe serbtë e kanë ditë atë punë. Kanë bashkëpunu me serbtë, shumë kanë bashkëpunu. Na kem qenë qaty qysh kem qenë. Kështu që, p’e pranoj, edhe sot e kësaj dite mirë që kem mbetë. Plus ish ni koleg, u mledhëm në dhomën teme aty tha, “Këta po dalin edhe po e thrrasim televizionin,” thashë, “Kqyre, ti mundesh me dalë, po çka me bo punëtori i thjeshtë, çka me bo motra që s’munet me gjetë punë. Duhet me mbetë”. Mirëpo, ai boni ni gaf edhe dul, vet dul. Tjetri filloi me shku qeshtu që kërkonin edhe dul.

Kaltrina Krasniqi: A keni qenë aty deri në vitin 1999?

Skender Boshnjaku: Po, deri në vitin 1999 aty. Me 21 qershor të vitit 2000 jom kthy.

Kaltrina Krasniqi: Ku keni qenë?

Skender Boshnjaku: Në Prishtinë, gjatë ktyne tre mujve kom qenë në Prishtinë i ngujun me grunë edhe me motrën e grusë. Mu me 20 e... ka qenë dita e parë e Bajramit... me 26 m’doket mars, 24 mars... bombardimi e mërkurë ka qenë, bombardimi filloi, domethanë e enjte 25, e premte 26... 28 mars me maska... bile unë kom qenë... bile gruja thoshte, “O djalë, kqyr çka po bohet”. Dola, a filloi revole, u ktheva. Në pizhame kem dalë pa kurfarë orientimi deri te semaforat ku osht’ tash ajo pompa

e benzinit italiane si quhet, ka qenë “Jugo Benzina” përpara edhe jom vendosë me ni banesë aty përballë asaj pompe.

Kem trokitë me ni derë, “A po na pranon?” Unë kom qenë në pizhame, gruja po ashtu edhe motra e grusë e smutë, s’kom mujt ka me ikë, ka me shku. Jom vendosë aty na kanë pranë, plus mas dy ditëve ata shkunë u rrethum n’tona antë me paramilitarë, nuk kom mujt me dalë. Unë kom qenë shumë n’krizë, gruja ka qenë shumë... qikjo gruja ka qenë shumë e fortë edhe ajo ka furnizu gati ni muj e gjysë t’u shku, t’u ble, t’u marrë bukë ka ardhë n’shpi edhe plus ajo osht’ shpi... fantazmë, n’hymje kanë qenë veç paramilitarët edhe këta të “Jedinstvos”.⁵ Ka qenë edhe...

Kaltrina Krasniqi: Për cilën ndërtesë saktë?

Skender Boshnjaku: E cila ndërtesë... kështu, si t’shkoni te... ku osht’ hapë ni... “Gresa”, “Gresa” kur t’shkoni kah... kur filloni në anën e majtë prej pompës t’benzinit që shkoni kah kafiteritë prej...

Kaltrina Krasniqi: “Kafet e vogla”.

Skender Boshnjaku: “Kafet e vogla”, domethanë përballë Ambasadës së Kroacisë, këtë anë tjetër. Ndaqi filloni prej ambasadës e këndej ose prej pompës të benzinit, ndërtesa e parë kolektive që osht’ menjëherë, e kaloni këtë... ni lokal, këtë lokalin, këtë pompën e benzinit ndërtesa e parë, hymja e parë, katin e parë aty kom banu tre muj ditë. I ngujum. Une e di çka kom përjetu edhe osht’ diçka shumë... mirëpo, gjithmonë më hiqet ajo që njerz të kanë pësuar ma shumë edhe vetit i thom, “Shuj kanë kalu ma shumë edhe s’ki nevojë”.

Plus, ditarin çka ka ndodhë në dhomën përballë kojshi, fqinjë... hinën... ka qenë aty ni... e OSCE-së ni... ka banu aty edhe ata meniherë i kanë thy dyrtë edhe janë vendosë aty. T’u marrë ndoshta ndonjë dokument se i huji ka banu aty. Edhe aty paramilitarët kanë banu, a policia a ku ta di unë dhe kom ndëgjju, “Këtij ia kputën hundën, këtij kështu...” tanë natën. Kështu që, shumë tmerr ka qenë dhe...

Kaltrina Krasniqi: Ku i keni pasë fmitë?

Skender Boshnjaku: Nji ka qenë jashtë, në Londër, tjetri ka qenë i ngujum me grunë e vet në Breg të Diellit.

Aurela Kadriu: Kur jeni largu prej shpisë “Te Miqtë”? Po mendoj...

Skender Boshnjaku: A “Te Miqtë”...

Aurela Kadriu: Kur jeni bartë?

⁵ Gazetë ditore serbe e Kosovës, dikur e vendosur në godinën e Pallatit të Shtypit “Rilindja”.

Skender Boshnjaku: Kështu, “Te Miqtë” kom banu deri në vitin 1997, po aty ka vazhdu vjehrra edhe ma tutje me banu, ka qenë e banushme. Dhe në shpi ktu ku jom, në Dardani, në Dragodan jom vendos në vitin 1997...

Kaltrina Krasniqi: Prandaj ju keni përfundu këtu te kjo pompa.

Skender Boshnjaku: Urdhno?

Kaltrina Krasniqi: Prandaj ju keni përfundu këtu te kjo pompa.

Skender Boshnjaku: Po, tek pompa. Une prej asaj shpije në Dragodan kom përfundu te pompa këtu. Edhe ka qenë situatë e tmerrshme, ni heshtje, ni situatë që vetëm ndonjë cicërimë ose ndonjë kroatje e sorrës ose diçka tjetër, maca ose ndonjë lehje. Ka qenë shumë tmerr! Kështu që, e kom përjetu 11 majin kur forcat ruse hynën në aeroport, si quhet aeroporti te...

Kaltrina Krasniqi: Adem Jashari?

Skender Boshnjaku: Adem Jashari po edhe ajo ku kanë qenë ushtria, maja, stacioni...

Kaltrina Krasniqi: Goleshi?

Skender Boshnjaku: Goleshi, po. Edhe shumë tmerr ka qenë atë natë, të shtëna, mitrolozi... se prej dritares tjetër anej. Ajo ka qenë me 11 maj se duhet ditur që me 10, me 11 qershor m’falni, me 11 qershor jo me 11 maj, se me 10 qershor osht’ Kumanova me... fillon mledhja, mbaron m’duket me 11, me 11 hyjnë forcat ndërsa NATO-ja me 12 qershor.

Kaltrina Krasniqi: Qysh ka qenë ai moment për juve?

Skender Boshnjaku: Oh, ai moment ka qenë i mrekullueshëm, bile prej, prej... ka qenë e shtunde kur ka hy NATO-ja, domethanë me 12 qershor e shtunde... me 11 qershor ka qenë e premte, jo, po, tamon 11 qershor e premte, 12 qershor e shtunë. Zakonisht nuk kom fjetë, por prej dritares ku kom banu osht’ pa mirë edhe shtëpia edhe kur e kom pa tenkun, ka qenë herët. Oh edhe sot e asaj... qitash në qit moment kom... shumë kom ndi ni gëzim, kom thanë, “O gru hinën NATO-ja, dal kape”. E tu u përpjekë qashtu kom vrapu derisa s’kom mujtë me arritë me e zanë tenkun, por kur u kthy e kom pa tenkun edhe i kom çu durtë edhe ka qenë ni mrekulli e madhe, diçka e pamundshme. Po edhe për mu ka qenë e pamundshme që krijohet qashtu atmosferë e dalldisjes që harrojnë njerëzit, kjo për mu osht’ diçka shumë e pabesueshme edhe e pa... diçka që s’kom pritë. Që harrojnë njerëzit solidaritetin e senet që bohen qashtu t’nxonë ndaj njoni-tjetrit, çohen meniherë kundër njoni-tjetrit, nuk e di.

Kaltrina Krasniqi: Fillove mandej...

Skender Boshnjaku: Urdhno?

Kaltrina Krasniqi: Mandej në vitin 1999 ju jeni kthy prapë në spital apo?

Skender Boshnjaku: Po, jom kthy. Domethanë, lufta ka zgjatë, domethanë mbaj në mend, domethanë '99 deri me 24 janar, shkurt, mars, 24 mars. Domethanë, 78 javë [ditë] ka zgjatë ajo bombardimi e lufta e krejt ajo pjesë. Marsi, prilli... me 21 qershor... se ka qenë ajo që çdo qytet e ka pasë datën e largimit të forcave ushake, e deri atëherë nuk u leju... edhe atëherë nuk jom kthy në shpi, s'jom kthy. Edhe derisa jom kthy... se fillun me hi njerëzit në shpija edhe s'kom guxu me e lshu banesën se fillun me hy... me qenë me të vërtetë korrekt se kanë qenë... shkun në Turqi edhe ka qenë e pamundshme me e lshu edhe kishin me hy edhe kishin ardhë në banesë tjetër. Po osht' puna që edhe atje në shpi kanë hy edhe me 21 qershor jom kthy. Përpara m'duket jom kthy me 19 qershor jom kthy në shpi, e me 21 qershor në punë, të 2000-shit. Po, po, 2000-shi...

Kaltrina Krasniqi: Në cilin vit...

Skender Boshnjaku: Urdhno?

Kaltrina Krasniqi: Nuk jeni kthy në punë në '99-tën po 2000-tën?

Skender Boshnjaku: Po, 2000-tën. Se në '99-tën na e kem braktisë klinikën në mënyrë... shumica në fillim të marsit, para bombardimeve jem kthy secili rrugës t'vet. Qysh ka mujt ka ikë, qysh ka mujt ka dalë, por une s'kom mujtë se motra e grusë ka qenë e smutë shumë, e palëvizshme edhe s'kom pasë mundësi qysh. Bile, nuk e di qysh atë ditë e kom mbajt në shpindë prej shpisë deri te, deri në fund të semaforat.

Kaltrina Krasniqi: Edhe mandej, në vitin tjetër, në vitin 2000 ktheheni prapë në punë.

Skender Boshnjaku: Po, në 2000-tën kthehna në punë.

Kaltrina Krasniqi: Edhe qysh ke me u kthy në punë?

Skender Boshnjaku: Po, në 2000-tën ka qenë, jom marrë vesh me telefonatë që n'ora 8:00 me u taku gjithë, gjithë së bashku n'rresht me hi në klinikë edhe gjithë së bashku... tash s'ka rëndësi aty kush ka hi, çka ka bo, nuk e di, nuk osht' me randësi. Veç me 21 qershor, ka qenë e hane m'doket, e hane, kem hy edhe e kem vazhdu punën. Aty kem taku drejtorin e dhunshëm, motrën e... Lila dhe kërkënd tjetër, kërkond tjetër. Tjertë... disa motra, kurse mjek tjetër s'ka pasë. Edhe mandej nuk shkoi edhe pak edhe ata shkun. Bile, bile kanë shku... e lexun që kanë me u likuidu edhe e kanë shfrytëzu rastin edhe kanë ikë.

Kaltrina Krasniqi: Mandej kur u kthyn shqiptartë, sigurisht kanë punu edhe ata me...

Skender Boshnjaku: Po t'gjithë në punë janë kthy, t'gjithë n'punë janë kthy edhe fillon jeta e përditshme, fillon jeta, fillon diçka që ka vazhdu deri sot e kësaj dite. E tjerat s'muj me i thanë se nuk kanë qenë puntë mirë.

Kaltrina Krasniqi: A ka pasë paragjykime...

Skender Boshnjaku: Po, po, ka pasë paragjykime ndaj meje shumë, si i shitun, si i poshtër, si gjithçka tjetër. Po t'iu kallxoj të drejtën ajo është e turpshme, ma kanë fut pamfletin me m'likfidu edhe m'kanë majt forcë, nashta mos me hi kjo ktu, a din, s'osht' me randsi ajo, po ju kallxoj juve po ju referohem.

Kaltrina Krasniqi: Mandej...

Skender Boshnjaku: Edhe ajo m'ka dhanë elan, forcë që t'përpiqem që deri në fund të jetës teme unë t'mbetem rrafsh 39 vjet e 6 muj. Mu s'ma merr mendja që dikush ka me arritë këtë. Ajo m'ka detyru me qenë shumë i përkushtum, me kqyrë me punu edhe kurgjo tjetër. Edhe e kom arritë atë.

Kaltrina Krasniqi: Mandej në vitin 2007...

Skender Boshnjaku: Kom dalë në penzion, në penzion. Nuk e kom hapë ordinancën private, sot e kësaj dite s'kom ordinancë private. Jom orientu me ni aktivitet t'cilin e kom shndërru me ni knaqësi, jom shndërru në ni Skender të vogël që vazhdon andrrat e fëminisë, me kërku, me qenë kureshtar, me i plotësu ato dëshirat që më kanë mungu. Shumë çka që sot i përjetoj edhe osht' ni bekim i madh që muj me shndërru edhe në ni fëmi që e realizoj gjithmonë ata që kom pasë dëshirë.

Kështu që, ajo osht' kënaqësia ma e madhe edhe ajo më mbanë sot e kësaj dite. Gjithnjë lëvizi, eci se jeta osht' lëvizje, gjithë kuptimi i jetës osht' lëvizje, lëvizje edhe kur flen njeriu osht' lëvizje edhe çdo atom osht' lëvizje, krejt osht' njeriu në lëvizje. Edhe vetvetës i thom, une çdo ditë lindi edhe çdo mramje vdes. Cila osht' ajo ditë nuk e di por zonjën vdekje e pres, kur vjen, urdhno zonja vdekje se ja ku jam edhe kurgjo tjetër. Edhe s'frikohem prej asni gjaje.

Kaltrina Krasniqi: Shumë faleminderit zotëri Boshnjaku.

Skender Boshnjaku: Ju lutem...

Aurela Kadriu: M'fal e pata veç edhe ni pyetje para se me përfundu. E përmendet shumë ma herët inagurimin e përmendores Vllaznim Bashkimi që keni ardhë...

Skender Boshnjaku: Po.

Aurela Kadriu: Që keni ardhë prej Pejës...

Skender Boshnjaku: Po, po.

Aurela Kadriu: A munesh me m'kallxu pak ma shumë? Çka ju thojshin që ju organizun si nxansa prej Pejës?

Skender Boshnjaku: Po na kanë pru sikurse kafshhtë. Na kanë ngarku në... kanë qenë furgonat asaj kohe të kafshëve, na kanë mbush qashtu në stacionin e Pejës atje dhe na kanë shkarku ku është stacioni, jo atje te Fushë Kosova, jo ku osht' stacioni i vërtetë i Prishtinës po këtu osht' ni ndërtesë e vogël ajo ka qenë... edhe kem zbritë, si sot më kujtohet balta, si kalon, balta, tash deri në gju e deri në përmendore kur ka qenë hapja na kemi qenë larg atje, veç na kanë mledh qashtu sa me ndëgju...

Aurela Kadriu: Çka ju thojshin?

Skender Boshnjaku: Urdhno?

Aurela Kadriu: Çka ju thojshin? Ku po shkojmë?

Skender Boshnjaku: Po shkojmë me fitoren e socializmit, fitore të komunizmit, fitoren e bashkim vallznimit, për Titon, për lumturi, për ideale, për... po rrjedh qumshtë e mjaltë e ku ta di une, ashtu si çdo ideologji që e lavdon vetëvetën.

Aurela Kadriu: E qysh ke tubimi?

Skender Boshnjaku: Urdhno? O ka qenë shumë aty. Veç na kanë vendosë ni vend edhe prit. Pankarta, "Rroftë shoku Tito" rroftë ky, rroftë ai, rroftë Lidhja e Komunistëve, rroftë Bashkim Vllaznimi. Qysh na kanë mledhë, prapë na kanë kthy. Veç po thom, si sot më kujtohet stacioni i vogël edhe çdo herë që kaloj andej edhe çdo ditë lëvizi më kujtohen ato ditë. E aty ka folë Svetozar Vukmanoviq - Tempo, ni nacionalist anti-shqiptar i përbetum.

Plus edhe ai osht' njo prej themeluesve, pos Dushan Mugoshës, themelues i Partisë Komuniste të Shqipërisë, Dushan Mugosha, Milladin Popoviqi dhe Svetozar Vukmanoviq - Tempo. Këta janë tre që e patën themelu Partinë Komuniste të, të Shqipërisë dhe ata i kanë mashtru që ka qenë konferenca e Bujanit, në Bujan në vitin, në janar të vitit '42 që i kanë premtu shqiptarëve që i kanë mashtru që ju osht' dashtë... i kanë mashtru që ju me e marrë Luftën Nacional Çlirimtare, me i mledhë shqiptarët... po aty s'ka pasë faj Fadil Hoxha, me thanë "Kqyre çfare janë serbtë, mirë që kom shpëtu". Po edhe aty osht' premtu që kur t'bohet, t'përfundon lufta, Kosova me i taku Shqipërisë. Po mandej ndodhë rrotullimi që ndodhë edhe qishtu.

Kaltrina Krasniqi: Faleminderit shumë.

Skender Boshnjaku: S'di a jom i qartë.

Kaltrina Krasniqi: Po jeni, shumë faleminderit.

Skender Boshnjaku: Edhe juve faleminderit. Nuk e di a ju kom ofru atë besimin e plotë edhe besoj që shumë e kom përjetu si ni angazhim maksimal edhe m'doket, s'di, e kom ndje vetën shumë të përgjegjshëm. Sikurse n'jetë që kam qenë gjithmonë edhe meniherë e kom pranë edhe e kom ndi

vetën, “Kqyre mos rrej. Je t’u dhanë ni provim para gjeneratave t’reja. Se bon vaki që nesër me ndi, kqyre na ka rrejt plaku”, e s’ju kom rrejt kurgjo.

Kaltrina Krasniqi: Shumë faleminderit!

Skender Boshnjaku: Edhe jom përpjekë... edhe shumica e qityne nuk më përmendin, shumica e ktyne, por une i përmendi. Unë nuk jom farë fetari, po ni pjesë e lexoj shpesh Kuranin, thom masi s’jom fetar kështu i devotshëm barem me lexu Kuranin. Edhe ni pjesë që mu m’pëlqen që në Kuran përmendet mosmirnjohja, osht’ diçka që nuk i takon personalitetit tim edhe unë në atë kuptim jom mirënjohës që m’keni ftu edhe besoj që nuk ju kom dalë nga ajo mirënjohje edhe ju përshtëndes.

Kaltrina Krasniqi: Shumë faleminderit!